

L I G J
Nr.8117, datë 9.7.1996

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.1465/1, DATË 12.4.1996 “PËR NJË
SHITESË NË LIGJIN NR.8041, DATË 30.11.1995 “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË
DEKRETIT NR.1274, DATË 9.11.1995 “PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.7936, DATË 18.5.1995 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7609, DATË 22.9.1992
“PËR TARIFAT DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat Kryesore Kushtetuese”,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimin me ndryshime të dekretit nr.1465/1, datë 13.4.1996 “Për një shtesë në ligjin nr.8041, datë 30.11.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1274, datë 9.11.1995 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7936, datë 18.5.1995 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” si vijon:

1. Titulli i dekretit bëhet:

“Dekret “Për një shtesë në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore”, ndryshuar me ligjin nr.8100, datë 28.3.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore (i ndryshuar nga disa ligje të tjera)””

2. Neni 1 i dekretit ndryshohet si vijon:

Në nenin 20/5 të ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifatat doganore” ndryshuar me ligjin nr.8100, datë 28.3.1996 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992, “Për tarifatat doganore” (i ndryshuar nga disa ligje të tjera)”, pas pikës “ë”, shtohet pika “f” me këtë përmbajtje:

“Për të gjitha llojet e kazanëve a rezervuareve, në të cilat depozitohet e ruhet gaz i lëngët i djegshëm, paisjet e mjetet teknologjike që shërbejnë e përdoren për mbushjen, transportimin ose shpërndarjen e gazit të lëngët të djegshëm e të bombulave.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet që nga data 12.4.1996.

Shpallur me dekretin nr.1547, datë 17.7.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha